

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Fillimi i procedurave për dhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, e llojit “Pa fryt”, ndodhur në fshatin Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Procedurat do të kryhen me të gjithë elementët përbërës të konkurimit, bazuar në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 30 000 lekë ha/vit, bazuar në pikën 34, të Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës, e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar.

Afati i dhënies në përdorim është 10 vjet.

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm e sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, ndodhur në fshatin Melgushë, “Për veprimtari në fushën e blegtorisë”.

4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit për subjektet pjesëmarrës do të jenë:

Nr	Kriteret e konkurimit	Pikët vlerësuese për elementet e konkurimit
1	Niveli i investimit	30 pikë
2	Niveli i punësimit	30 pikë
3	Oferta e detyrimit mujor/vjetor të qirasë	40 pikë

5. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurentët pjesëmarrës është:

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesën e subjektit bashkë me gjeneralitetet, për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të, të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit vjetor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit.
- b) Plan biznesin e hollësishëm për vënien në funksion të pronës, në të cilin duhet të përshkruhet qartë: Plani i punësimit, plani i investimeve, treguesit që do realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë se $\frac{1}{4}$ e afatit të kontratës, të cilat duhet të ruhen deri në fund të afatit të kontratës, si dhe siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë, ose personit fizik, në çdo faqe të tij.
- c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - Deklaratë mbi NIPT/NUIS- in e subjektit kërkues.
 - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore.

- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Në rastet kur subjekti konkurues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në pronë shtetërore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

6. Vendi i zhvillimit të konkurimit: Adresa: Ambientet e Bashkisë Vau Dejës (Zyra e Aseteve).

7. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Datë 27.08.2026, ora 10.00.

8. Kërkesa për pjesëmarrje në konkurim, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit.